

VENDIM
Nr. 152, datë 18.9.2020

**MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/5 prot., datë 11.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 8.6.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 62/16 prot., datë 10.6.2020, ka kryer njoftimin në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 723/3 prot., datë 19.6.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar apo atij të konsideruar si i nevojshëm/shtesë në kuadër të aplikimit.

- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsiston si vijon:

Neni 9, pika 1. Forma e aplikimit

i. Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare që nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

xi. Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për Aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse.

Germa “e”. Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale

Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre vjetëve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit.

vi. Një plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës

Licenca për tregtimin e gazit natyror duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm, që përfshin:

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

- Pas depozitimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë, përkatësisht me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 723/7 prot., datë 13.7.2020, nr. 723/8 prot., datë 17.7.2020, nr.

697/17 prot., datë 24.7.2020, si dhe nr. 723/10 prot., datë 12.8.2020, ka rezultuar se ka mbetur ende dokumentacion/informacion pa plotësuar, si vijon:

- **Germa “d”**. Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor

vi. Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse – plotësuar pjesërisht.

- **Germa “e”**. Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale

ii. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese të akredituar, për secilin prej tre vjetëve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit – plotësuar pjesërisht.

vi. Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve – plotësuar pjesërisht.

- **Dokumente specifike për llojin e licencës**

ii. Garancinë që cilësia e tregtimit të gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit – pa plotësuar.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit – plotësuar pjesërisht.

- Edhe pse shoqëria ka depozituar dokumentacion e informacion për çdo kërkesë të rregullores, rezulton që dokumentacioni nuk është ende i plotësuar tërësisht sipas kërkesave specifike të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Megjithëse shoqëria ka treguar vullnetin dhe angazhimin saj për të plotësuar çdo kërkesë të rregullores, është e nevojshme më shumë kohë, për vijimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kësaj kërkesë, si dhe vlerësimin e kompetencës lëndore të ERE-s mbi këtë kërkesë.

- Në mbështetje të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me kërkesën për shtyrjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti